



Prishtinë: 16.04.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1161_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1924_04_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **30.04.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 05.06.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N. Xh. nga Fushë Kosova me shifër të konsumatorit DPR 90038952, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1924_04_19** i datës 04.04.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 30.04.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se KESCO konstaton se korrigjim i datës 15.02.2016 është në përputhje me rregullat në fuqi, dhe se shpenzim i regjistruar në njehsorin nr.63612829 është faturuar por me vonesë për shkak se në muajin 05/2015 është bërë një gabim teknik ku është bërë ndërrim i njehsorit por programi nuk e ka regjistruar. KESCO ka theksuar se shpenzimi në të dy tarifat dëshmohet edhe nga lexuesi i KESCO-s i cili është bërë me HHU. Vendimi i DMK në ZRRE bazohet vetëm në rrjedhën e energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit. KESCO ka theksuar se nëse krahasohen kWh pas periudhës kontestuese dhe nëse korrigjimi i KESCO-s është i saktë atëherë shihet se shpenzimi është i njëjtë dhe mesatarisht konsumatori shpenzon 500 – 600 kWh për muaj. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1924_04_19 i datës 04.04.2019 për konsumatorin N. Xh. me shifër DPR – 90038952 dhe të mbetet në fuqi faturimi në kartelën e konsumatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrëgjim i datës 15.02.2016 është në përputhje me rregullat në fuqi, ZRRE konstaton se kjo nuk qëndron pasi që gjatë analizës së bërë korrëgjimit të KESCO-s janë vërejtur shume paqartësi e të cilat KESCO nuk i ka argumentuar. Duhet theksuar se korrëgjimi i KESCO është bërë me datë 15.02.2016 përmes urdhërlejimit nr.83861DPR-90038952-90038952 me ç'rast e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë shtesë në vlerë prej 208.71€, dhe atë duke bërë shpërndarjen e shpenzimit prej periudhës 05/2014 e deri më 06/2015 (periudhë 14 mujore), si dhe duke i theksuar se kjo ngarkesë shtesë bëhet për shkak të gabimit të bërë të gjendjes fillestare të tarifës së lartë pari së kjo gjendje nuk është faturuar. Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes korrëgjimin e lartëcekur dhe thekson se korrëgjimi shtesë është bërë ashtu që është marrë gjendja TL=4102 kWh dhe TU=3116 kWh si gjendje e shpenzimit e konsumatorit e periudhës 06/2015 dhe se si gjendje fillestare është marrë gjendja 05/2014 prej TL=1 kWh dhe TU=2 kWh, dhe këtë diferencë të shpenzimit e ka shpërndarë proporcionalisht nëpër periudhën 05/2014 – 06/2015 dhe ka rezultuar ngarkesa shtesë prej 208.71€. Por Bordi i ZRRE thekson se bazuar në shkresat e lëndës KESCO nuk ka dhënë sqarime se nëse gjendja e shpenzimit në periudhën 06/2015 është marrë TL=4102 kWh dhe TU=3116 kWh dhe për periudhën 05/2014 është marrë si gjendje fillestare TL=1 kWh dhe TU=2 kWh, atëherë me çfarë gjendje konsumatori është faturuar me shpenzim prej periudhës 04/2005 e deri më 04/2014. Bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se konsumatori prej periudhës 04/2005 e deri më 04/2014 është faturuar me shpenzim të energjisë elektrike vetëm në tarifën e lartë (faturimi gjatë kësaj periudhe është bërë si konsumator njëtarifor pra me tarifa të grupit tarifor 6), ndërsa nga periudha 05/2014 e deri më 06/2015 konsumatori është faturuar me shpenzim vetëm në tarifën e ulët (faturimi gjatë kësaj periudhe është bërë si konsumator njëtarifor), ndërsa nga periudha 07/2015 e tutje konsumatori është duke u faturuar me shpenzim të energjisë elektrike në të dy tarifatat. KEDS dhe KESCO nuk kanë dhënë asnjë sqarim se ka ardhur që njehsori elektrik i konsumatorit herë ka regjistruar energjinë në tarifën e lartë e herë në tarifën e ulët, e pastaj në të dy tarifatat, si dhe të mos ketë asnjë sqarim për këtë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se shpenzimi i regjistruar në njehsorin nr.63612829 është faturuar por me vonesë për shkak se në muajin 05/2015 është bërë një gabim teknik ku është bërë ndërrim i njehsorit por programi nuk e ka regjistruar, Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar me kujdes procesverbalet e vet KEDS-it, dhe ka vërejtur se ka disa mos përputhje mes procesverbaleve dhe rrjedhës së energjisë elektrike, dhe se nuk është dhënë asnjë sqarim për këtë. Bordi i ZRRE-së konstaton se gjendja e shpenzimit e njehsorit elektrik nr.63612829 prej TL=004101 kWh dhe TU=003122 kWh e evidentuar në procesverbalin e inspektimit të lartcekur nuk përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të muajit 06/2015 dhe 07/2015. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se nga analiza e bërë gjendjes së njehsorit elektrik të evidentuar në procesverbalin të ndërrimit të njehsorit elektrik të periudhës 07/2015 dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive të muajit 07/2015 konstatohet se ka mospërputhje, pasi që gjendje në rrjedhën e energjisë elektrike në muajin 07/2015 ka qenë TL=23588 kWh dhe TU=3122 kWh, ndërsa në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik ka qenë TL=4102 dhe TU=3122 kWh, pra shihet se mospërputhja është në tarifën e lartë.

Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalin e kalibrimin si dhe protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik edhe ka vërejtur se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes, dhe se përveç tjerash ka konstatuar se njehsori elektrik është në rregull, nuk është i djegur, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, njehsori nuk ka probleme me sistemet matëse etj. Pra sipas këtyre dy dokumenteve të KEDS-it nuk është vërejtur që njehsori ka ndonjë defekt teknik, përveç që gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në tarifën e lartë nuk përputhet, ndërsa gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në tarifën e ulët përputhet.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se vendimi i DMK është i bazuar vetëm në rrjedhën e energjisë elektrike, respektivisht në krahasimin e shpenzimeve, Bordi i ZRRE thekson se rrjedha e energjisë elektrike, respektivisht krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese është një indikator mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Për këtë edhe Bordi i ZRRE ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë elektrike për të parë se si ka rrjedhur energjia elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, si dhe me njehsorët elektrik që ka pasur konsumatori në funksion. Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatorit i është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik në muajin 07/2015, ku është larguar njehsori elektrik nr.63612829 dhe është vendosur njehsori i ri elektrik nr.64101630. Bordi i ZRRE nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e ri elektrik nr.64101630 prej periudhës 07/2015 e deri më 10/2017 ka qenë **523.32 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik kontestues prej periudhës 04/2005 e deri më 06/2015 është **220.66 kWh/muaj**. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të njehsorit të vjetër nr.63612829 kur ky njehsor ka qenë duke regjistruar energji elektrik vetëm me një tarifë për periudha të njëjta kohore: mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e periudhës 05/2013 e deri më 04/2014 ka qenë 217.75 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 05/2014 e deri më 04/2015 ka qenë 218.25 kWh/muaj. Pra Bordi i ZRRE thekson se bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive shihet qartë se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike kur njehsori elektrik një periudhë ka regjistruar energji elektrike vetëm me tarifën e lartë dhe pastaj në periudhën tjetër vetëm në tarifën e ulët, e që nëse nuk do të kishte regjistruar saktë atëherë shpenzimi i energjisë elektrike pas periudhës kontestuese do të duhej të rritej.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit N. Xh. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.